




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVES	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/DPK</b>	Nr Prot. Br Prot. <b>01-512/2013</b>
Nr. ffaq Broj stranica <b>02</b>	Data Datum <b>20.02.2013</b>
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit. Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.01.2013, nxjerr këtë:

## V E N D I M

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-3637/12, për zyrtarin e lartë z. Fadil Krasniqi, Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dhen dorëheqje nga funksioni i anëtarit të Bordit në Kompaninë Publike "INFRAKOS" sh.a.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqitën rrethana të reja.**

## A r s y e t i m

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.**

Pas informatës së marrë, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-3637/12 që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z.Fadil Krasniqi, Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari e lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës, ka qenë duke ushtruar edhe funksionin e anëtarit të Bordit në Kompaninë Publike "INFRAKOS" sh.a, që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 22.10.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave me datën 31.10.2012, z.Fadil Krasniqi, Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës është ardhur në takim në zyrat e AKK-së, dhe na ka njoftuar se e ka marr shkresën njoftuese dhe dëshiron të njoftohet me detal për situatën që dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Gjatë takimit e kemi njoftuar për situatën që gjendet z. Krasniqi, ku edhe është pajtuar se ushtron dy funksionet Publike, mirë po është arsyetuar se për këtë situatë nuk e ka njoftuar askush se është në kundërshtim me ligjin në fuqi, dhe se është zgjedhur me konkurs publik, por është zotuar se do të shfrytëzoj të gjitha mundësit dhe në afatin ligjore do të bej publike dorëheqjen nga njeri funksion, që të mos vazhdoj të jetë në këtë situatë.

Me datën 12.11.2012, z.Fadil Krasniqi, ka sjellë në Agjenci deklaratën për ofrimin e dorëheqjes nga funksioni i anëtarit të Bordit në Kompaninë Publike "INFRAKOS" sh.a.

Andaj në bazë të dëshmive dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë, z.Fadil Krasniqi, Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës, nuk gjendet më në situatën e përshkruar si Konflikt të mundshëm të Interesit dhe ka shmangur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit Publik, pasi që ka dhen dorëheqje, dhe nuk ushtron me pozitën e anëtarit të bordit në Kompaninë Publike "INFRAKOS" sh.a.

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si Nënkyetar i Komunës së Fushë Kosovës, dhe funksionit publik të anëtarit të bordit në Kompaninë Publike "INFRAKOS" sh.a.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqitën rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

